



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË



Programi: **Master shkencor**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: SIGILOGRAFIA, NUMIZMATIKA DHE HERALDIKA

<i>Pedagogu:</i>	Prof. As. Dr. Ilira Çausi, Ph.D.c. Andi REMBECI
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS: (15 javë -2 leksione 1seminare në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/ Semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Sigilografia, Numizmatika dhe Heraldika përbëjnë disiplina shkencore-ndihmëse të Historisë, të cilat i ndihmojnë historianët në hulumtimin dhe interpretimin kritik të burimeve zyrtare historike.

Sigilografia ka si objekt studimi vulat e arta, të argjendta dhe prej plumbi, që shoqëronin dokumentet zyrtare, letrat, por edhe pakot tregtare. Nëpërmjet mbishkrimeve dhe ikonografisë së vulave del në pah struktura shtetërore dhe administrative e hierarkisë perandorake dhe kishtarë si dhe përftohen të dhëna shumë të rëndësishme rreth prosopografisë së Mesjetës Bizantine. Me përdorimin e argumenteve sfragjistike dhe në ndërthurje me dëshmitë e shkruara, kjo lëndë synon t'i familjarizojë studentët me strukturën politike të shtetit bizantin dhe me sistemin e funksionimit të administratës shtetërore dhe kishtarë të perandorisë. Lënda do të trajtojë njëkohësisht edhe çështje të posopografisë dhe përmes saj do të prekë tema që lidhen me shtresëzimin social të botës bizantine.

Numizmatika, nga na tjetër, merret me studimin e tipologjisë së monedhave bizantine dhe me hulumtimin e parimeve, ekonomike dhe të tjera, që përcaktonin prodhimin dhe qarkullimin e tyre. Gjithashtu, numizmatika shqyrton rolin e monedhave si mbartës të ideologjisë politike dhe fetare të autoritetit bizantin. Trajtimi i numizmatikës, do të fokusohet në evoluimin numizmatik (sistemi monetar, përmasat e prodhimit të monedhave, organi administrativ që shtypte monedhat etj.) të Perandorisë Bizantine që nga shek. IV dhe deri në Rënien e Kostandinopojës më 1453. Po ashtu, do të shqyrtohen edhe fenomenet numizmatike që u shfaqën pas vitit 1204 në hapësirën Ballkanike dhe shqiptare si edhe në hapësirat e dikurshme bizantine, por që tashmë gjendeshin në duart e latinëve dhe të venedikasve. Më tej, bazuar në dëshmitë numizmatike, do të analizohen fenomene të caktuara ekonomike që lidhen me përhapjen e shkëmbimeve monetare të komuniteteve lokale, rurale apo urbane. Një vend të rëndësishëm, do të ketë edhe analizimi i reformave numizmatike dhe kuptimi apo gjurmimi i fenomeneve të krizës ekonomike në ndërthurje me dëshmitë burimore.

Heraldika, si një dukuri historike-kulturore, u kristalizua gjatë shek. XI-XII të Mesjetës e në vijim. Përdorimi i simboleve heraldike në Bizant, si përfaqësim simbolik i familjeve, mund të gjurmohet përgjithësisht pas restaurimit të Perandorisë Bizantine më 1261 dhe mbretërimit të dinastisë së Paleologëve. Gjatë kësaj periudhe, perandoria ishte shumë më e hapur me portet e perëndimit dhe e lidhur në aleancë me dinasti të shquara perëndimore. Heraldika pati përhapje në

gjithë Evropën, duke përfshirë Evropën Mesdhetare dhe hapësirën shqiptare. Në Shqipëri, heraldika, si pjesë përbërëse e heraldikës Evropiane, kaloi kryesisht tre faza zhvillimi. Faza e parë lidhet me simbolet e principatave mesjetare shqiptare, gjurmët më të hershme të së cilës i gjejmë në shek. XIII me simbolin e Dhimitrit, sundimtarit të Principatës së Arbërit. Kjo periudhë shënon edhe arritjen më cilësore dhe masive të heraldikës shqiptare. Në fazën e dytë, ajo u zhvillua në ato territore shqiptare që mbetën nën sundimin e Venedikut dhe, në fazën e tretë, heraldika ndeshet kryesisht në komunitetet arbëreshe brenda dhe jashtë trevave të Ballkanit. Gjatë trajtimit të lëndës, studentët do të aftësohen, përmes literaturës dhe materialeve pamore, në interpretimin e emblemave heraldike dhe në vendosjen dhe kuadrumin e tyre në hapësirën kronologjike dhe historike.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje në Sigilografinë Bizantine.
- *Terminologjia, fusha studimore, llojet e vulave, mënyra e prodhimit, evoluimi i shkrimit.*
2. Vulat perandorake dhe vulat e datuara prej plumbi.
3. Ikonografia e vulave bizantine gjatë periudhave të ndryshme.
4. Vulat bizantine prej plumbi si burime historike për kuptimin e kancelarisë bizantine.
5. Numizmatika Bizantine:
- *Sistemi numizmatik bizantin: terminologjia dhe shqyrtimi sipas periudhave (324-1453).*
6. Organizimi dhe funksionimi i punishteve monedhëprodhuese sipas periudhave:
- *Struktura administrative, kontrolli i prodhimit, teknologjia.*
7. Ikonografia monedhave bizantine: shqyrtimi, simbolizmi, komenti historik dhe lidhja me artin monumental.
8. Monedha bizantine jashtë kufijve të perandorisë (qarkullimi dhe ndikimet).
9. Dëshmitë numizmatike si burime të drejtpërdrejta të historisë bizantine: qasje metodologjike dhe fusha e studimit.
10. Stacione në evoluimin e numizmatikës mesjetare evropiane:
- *Punishtet monedhëprodhuese të Serbisë dhe Bullgarisë (shek. XIII-XV)*
- *Monedhat e përdorura gjatë sundimit latin dhe venedikas (1204-1566)*
- *Qarkullimi i monedhave në Mesdhe gjatë fundit të shek. XIII-1453.*
11. Monedhat në hapësirën shqiptare në periudhën mesjetare.
12. Lindja dhe evoluimi i heraldikës në Perëndim.
13. Përhapja dhe evoluimi i heraldikës në Lindje.
14. Heraldika shqiptare dhe fazat e zhvillimit të saj.
15. Rëndësia e heraldikës për historinë e mesjetës shqiptare.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 5-10 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Gj. Varfi, *Heraldika Shqiptare*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2000.
2. H. Longuet, *Introduction a la Numismatique Byzantine*, London, 1961.
3. N. Oikonomides, *Studies in Byzantine Sigillography*, Dumbarton Oaks Pub Service, December 1987.

Literatura plotësuese:

1. A. Matkovski, "Stemat shqiptare në të kaluarën", *Gjurmime Albanologjike* 2 (Prishtinë 1969).
2. Dh. Pilika, "Shqiponja Arbërore si simbol i Dukagjinëve", *Ylli* 10 (1966).
3. G. Castellani, "Albania numismatica", *Rassega Numismatica*, Romë 1932.
4. H. Ceka, Probleme të Numizmatikës Ilire, Tiranë
5. H. Goodacre, *A Handbook of the Coinage of the Byzantine Empire*, 3 vols, London, 1928-1933.
6. Hahn, Wolfgang, *Moneta Imperii Byzantini*, 3 vols, Vienna, 1973-81.
7. L. Malltezi, "Rreth origjinës së flamurit të Skënderbeut", *Studime historike* 3 (1987).
8. M. F. Hendy, *Studies in the Byzantine monetary economy c. 300-1450*, London, 1985.
9. M. Woloszyn, (ed.), *Byzantine Coins in Central Europe between the 5th and 10th Centuries*, Krakow, 2009.
10. Michail-Dimitri Sturdza, *Grandes familles de Grèce, d'Albanie et de Constantinople*, Paris 1983
11. P. Papadopoulou, "Five Lead Seals from Byzantine Butrint (Albania)", *Studies in Byzantine Sigillography* 11 (2012), 133-142.
12. P. Xhufi, "Familje dhe stema feudale nga Myzeqeja", gaz. *Myzeqeja* 5 (1995).
13. P. Xhufi, "Stema e Gjergj Kastriotit Skënderbeut", *Shkenca dhe jeta* 1 (1990).
14. R. Alfred, Bellinger dhe Ph. Grierson, eds. *Catalogue of the Byzantine Coins in the Dumbarton Oaks Collection and in the Whittemore Collection*, Washington D.C., 1966 - 1999.
15. Sear, David R., *Byzantine Coins and Their Values*, London, 1987.
16. T. Geci, "Sfragjistika e Kastriotëve", *V Mbledhje Ndërkombëtare Studimesh Shqiptare XI*, Palermo 1969.
17. Th. Popa, "Të dhëna mbi princët mesjetarë shqiptarë në mbishkrimet e kishave tona", *Buletin për Shkenca Shoqërore* 2 (1957).
18. The Oxford Heraldry, ed. Th. Woodcoc J.M Robinson, Oxford University press, 1988

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. As. Dr. Eva TAFILI

Tiranë, 2016